



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10.5.2023

Nr: 474

Ora: 13:30

VENDIM
PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTIT
VETËDEKLARUES Z. DEDË PAL PALI, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN BASHKIAK, I
PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA KONSERVATORE" PËR BASHKINË TIRANË**

Sot më datë 10.05.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Dedë Pal Pali, kandidat për anëtar në Këshillin Bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Konservatore" për Bashkinë Tiranë.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5 dhe 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

- (1) Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin

Data: 10.5.2023 Nr: 474
Ora:13:30



"Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Dedë Pal Pali, kandidat për anëtar në Këshillin Bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Konservatore" për Bashkinë Tiranë"

e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për Kryetar Bashkie apo anëtarë në këshillat bashkiak”.

- (2) Me vendim të KQZ, z. Dedë Pal Pali, është regjistruar si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i mbështetur nga “Partia Konservatore”.

Nga subjekti zgjedhor për këtë kandidat në datën 21.03.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. Unik TR-KONS-59. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit.

KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB). Në përgjigje të kësaj kërkesë të KQZ,-së, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet komunikimit elektronik ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Dedë Pal Pali, ku konstatohet se kandidati në fjalë nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

- (3) Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Dedë Pal Pali, rezulton se:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitete të mëparshme, konkretisht ka ndryshuar rubrikën e mbiemrit, nga “Ramaj” në “Pali”.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, Pyetjes 2 “A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar: “Bazel akuzë për shitje narkotikësh, vendim nr. 3000 527 Urteil BES Strafgerichts, vom 10 Juni 2005, Landchaft. Për të cilin deklaron se nuk ka marrë dijani pasi vendimi jopërfundimtar është apeluar nga ana e tij.
- Pyetjes 3 “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar: “Bazel Landchaft Zvicër” Dyshim përdorim narkotikësh periudha 2003.
- Pyetjes 7 “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar: “Lozanë Zvicër, Bazel akuzë për shitje narkotikësh, vendim nr. 3000 527 Urteil BES Strafgerichts, vom 10 Juni 2005 Landchaft. Për të cilin deklaron se nuk ka marrë dijani pasi vendimi jopërfundimtar është apeluar nga ana e tij.
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar : Se ka

jetuar në Lozanë, Zvicër“ në periudhën 1998-2008, për arsye emigrimi dhe familjare.

- (4) Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, KQZ çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, KQZ, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Dedë Pal Pali, kandidat për anëtar në Këshillin Bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Konservatore” për Bashkinë Tiranë dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI